Transportonin kanabis me motorçikletë, 2 të arrestuar në Cërrik

Shpërndaje

13:36 08/01/2023

Dy persona janë arrestuar në Cërrik pasi u kapën duke transportuar 10.4 kg kanabis. Të arrestuarit A.T. 27 vjeç dhe E.J. 20 vjeç u ndaluannë hyrje të fshatit Klos duke udhëtuar me një motorçikletë pa targa, me të cilën transportonin 2 thasë me kanabis.

Në kërkim për këtë ngjarje është shpallur edhe një person i tretë, një 33-vjeçar, si bashkëpunëtor në këtë aktivitet.

27-vjeçarit me iniciale A.T. iu gjet një pistoletë me fishekë në fole gati për qitje.

Sipas policisë, këta persona në bashkëpunim me të tjerë, prej disa kohësh ushtronin veprimtaritë kriminale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në territorin e qarkut të Elbasanit.

Policia sekuestroi 10.4 kg kanabis, 1 pistoletë, municion luftarak dhe 3 celularë. Gjithashtu, u sekuestruan edhe 4 armë gjahu, 1 armë sportive dhe një shumë parash të dyshuara të përfituara nga kjo veprimtari kriminale, të cilat u gjetën gjatë kontrolleve në banesat e dy të arrestuarve.

Vijon puna për identifikimin, kapjen dhe vënien në pranga të shtetasve të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale. ***/tvklan.al***

TË NGJASHME

Transportonin kanabis me motorçikletë, 2 të arrestuar në Cërrik

12:36 08/01/2023

Gjenden mbi 400 mijë Euro në banesën e Rozeta dhe Havier Dobit, i kishin fshehur në tubin e aspirimit

10:48 08/01/2023

Vodhën dyqanin nën kërcënimin e kallashnikovit, 2 të arrestuar në Durrës. Zbulohen edhe vjedhjet e tjera

08:48 08/01/2023

Rumuni tenton të trafikojë drogë përmes doganës së Morinës, arrestohet nga policia

08:14 08/01/2023

Vrau shqiptarin pasi tentoi t'i shembte shtëpinë me ekskavator, avokatët e italianit: Mbrojtje e ligjshme

22:50 07/01/2023

Kontroll në banesën e Ervis Martinaj në Surrel

19:40 07/01/2023

Arrestohen në vende të ndryshme të BE 4 shqiptarë të kërkuar nga Britania

19:10 07/01/2023

U plagos nga plasja e gomës së kamionit, mjeku: Gjendja e efektivit e rëndë

17:17 07/01/2023

E hodhi foshnjen në lumë, ditën e krimit 32-vjeçarja shkoi për të tërhequr bonusin e bebes

16:41 07/01/2023

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.